

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 31425/06

**OFRUES SHQIPTAR I SHËRBIMIT ONLINE SHPK
KUNDËR SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 2 prill 2024 si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 31425/06) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) më 1 gusht 2006 nga “Ofrues Shqiptar i Shërbimit Online” sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e themeluar në Shqipëri (shoqëria kërkuese), dhe e përfaqësuar nga z. S. Puto, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën qeverinë e Shqipërisë (Qeveria) të përfaqësuar nga Agjentja në atë kohë, znj. S. Meneri, më pas nga Agjentja znj. E. Hajro dhe Agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve,

pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Shoqëria kërkuese është operator i telekomunikacionit. Sipas regjistrimit shtetëror të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, anëtarët e shoqërisë kërkuese ndërmjet 2009-s dhe 2021-shit ndryshuan dhe emri i shoqërisë ndryshoi në fillim në “Primo Communications” sh.p.k. dhe më pas në “TIBO Communications” sh.p.k. Në këtë vendim, do të përdoret emri i mëparshëm.

2. Çështja ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të së drejtës së shoqërisë kërkuese për akses në gjykatë dhe të së drejtës së saj për gezimin e qetë të pronës.

A. Rrethanat e çështjes

3. Në vitin 2001, shoqëria kërkuese kërkoi pa sukses të lidhte një marrëveshje interkoneksioni për ofrimin e shërbimeve të internetit me “Albtelecom” sh.a., një ofrues me fuqi të ndjeshme i caktuar nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit (ERT).

4. Në mungesë të përgjigjes nga ofruesi me fuqi të ndjeshme, më 19 shtator 2001, shoqëria kërkuese i kërkoi ERT-së, sipas nenit 43 të ligjit për telekomunikacionin, që të rregullonte marrëdhëniet e saj me ofruesin me fuqi të ndjeshme (shihni “Legjislacioni i brendshëm përkatës” më poshtë).

5. Më 27 shtator 2001, ERT-ja i kërkoi ofruesit me fuqi të ndjeshme që t’i përgjigjej kërkesës së shoqërisë kërkuese për të negociuar një marrëveshje interkoneksioni për ofrimin e shërbimit të internetit. Në shkresë, po ashtu, thuhej se nëse çështja nuk zgjidhej brenda dy muajve pas fillimit të negociatave, ERT-ja do të zbatonte një marrëveshje standarde interkoneksioni dhe tarifat përkatëse.

6. Më 19 nëntor 2003, Bordi Ekzekutiv i ERT-së miratoi vendimin nr. 148, me të cilin vendosi që marrëdhëniet ndërmjet ofruesit me fuqi të ndjeshme dhe ofruesve të shërbimeve të internetit (ISP) të rregulloheshin me marrëveshje interkoneksioni.

7. Më 2 dhjetor 2003, ERT-ja informoi ofruesin me fuqi të ndjeshme, si më poshtë:

“Në mbledhjen e tij të datës 19 nëntor 2003, Bordi Ekzekutiv i ERT-së shqyrtoi kërkesat e ISP-ve të licencuara nga ERT-ja për ofrimin e shërbimit të internetit, për të lidhur marrëveshje interkoneksioni me “Albtelecom”....

Bordi Ekzekutiv konkludoi se kërkesat e ISP-ve për lidhjen e marrëveshjeve të interkoneksionit ishin të justifikuara.

Në bazë të nenit 43 të ligjit për telekomunikacionin, ERT-ja urdhëron Albtelecom-in të lidhë marrëveshje interkoneksioni me ISP-të brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky urdhër hyn në fuqi më 5 dhjetor 2003.”.

8. Më 17 dhjetor 2003, ERT e informoi shoqërinë kërkuuese si më poshtë:

“Në përgjigje të shkresës suaj të datës 17 tetor 2003, ju informojmë se Bordi Ekzekutiv i ERT-së ka vendosur t’i kërkojë Albtelecom-it të lidhë marrëveshje interkoneksioni me ISP-të. Bashkëngjitur gjeni shkresën drejtuar “Albtelecom” ‘Për detyrimin për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit’”.

9. Në janar 2004, shoqëria kërkuuese ngriti një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë kundër ofruesit me fuqi të ndjeshme. Ajo i kërkoj gjykatës të urdhërojë ofruesin me fuqi të ndjeshme që të lidhë një marrëveshje interkoneksioni dhe të marrë dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar.

10. Më 2 prill 2004, ERT-ja i dërgoi një shkresë ofruesit me fuqi të ndjeshme sipas të cilës:

“Në vijim të urdhrit nr. 1341, të datës 2 dhjetor 2003, të lëshuar nga ERT-ja në bazë të vendimit nr. 148, të 19 nëntorit 2003, të Bordit Ekzekutiv të ERT-së, për lidhjen e marrëveshjeve të interkoneksionit ndërmjet operatorit “Albtelecom” dhe ISP-ve, deri më 16 prill 2004 [ju] duhet t’i dërgoni ERT-së kopjet e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve ose versionin tuaj zyrtar të paraqitur për negociim”.

11. Ofruesi me fuqi të ndjeshme paraqiti një kundërpadi ku i kërkoj gjykatës të rrëzonte pretendimet e shoqërisë kërkuuese sepse ishin jashtë kompetencës lëndore të gjykatës. Më 20 tetor 2004, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi kundërpadinë.

12. Më 10 shkurt 2005, Gjykata e Lartë miratoi ankimin e ofruesit me fuqi të ndjeshme kundër vendimit të 20 tetorit 2004. Ajo e prishi atë vendim dhe e zgjidhi çështjen duke u shprehur se pretendimet e shoqërisë kërkuuese ishin jashtë kompetencës së gjykatës. Në veçanti, Gjykata e Lartë u shpreh se në përputhje me nenin 43 të ligjit për telekomunikacionet, shoqëria kërkuuese duhej të kishte përdorur mjet juridik administrativ për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit – kërkesë në ERT, gjë që nuk e bëri. Gjykata e Lartë më tej u shpreh se një gjykatë nuk mund të urdhëronte lidhjen e një kontrate – kjo ishte kompetencë e një autoriteti administrativ, ndërsa gjykata ishte kompetente për të shqyrtuar pasojat e çdo shkeljeje të detyrimeve ligjore.

13. Më 23 maj 2005, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi se pretendimet e shoqërisë kërkuuese ishin jashtë kompetencës së saj dhe e pushoi procesin.

14. Shoqëria kërkuuese depozitoi një ankim kushtetues kundër vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 10 shkurt 2005. Ajo pretendoi, duke iu referuar shkresës së ERT-së të datës 2 dhjetor 2003, se kishte shteruar mjetet juridike administrative.

15. Më 6 shkurt 2006, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankimin kushtetues të papranueshëm, duke konstatuar se nuk kishte pasur shkelje të së drejtës së shoqërisë kërkuuese për një seancë dëgjimore të drejtë.

16. Më 1 nëntor 2007 dhe 1 shkurt 2009, shoqëria kërkuuese lidhi marrëveshje interkoneksioni me “Vodafone Albania” sh.a., një tjetër ofrues me fuqi të ndjeshme.

B. Legjislacioni i brendshëm përkatës

1. *Ligji për telekomunikacionet, ligji nr. 8618, datë 14 qershor 2000, siç ishte në fuqi në kohën në fjalë*

17. Ligji për telekomunikacionet rregullonte shërbimet e telekomunikacionit në Shqipëri (neni 1).

18. “Interkoneksion” është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të telekomunikacioneve me rrjet tjetër përdoruesi për qëllim të përdoruesit përkatës të tyre të lidhen dhe të komunikojnë me njëri-tjetrin (neni 2).

19. Ligji për telekomunikacionet krijoi Entin Rregullator të Telekomunikacionit (ERT) i cili ishte përgjegjës, *inter alia*, për rregullimin e interkoneksionit të rrjeteve të telekomunikacionit (neni 9). ERT-ja caktoi ofruesit e telekomunikacionit me fuqi të ndjeshme në treg (“ofruesi me fuqi të ndjeshme”, neni 11).

20. Një organizëm me fuqi të ndjeshme duhej të vinte në dispozicion të ofruesve të tjerë linjat dhe pajisjet e interkoneksionit, duke aplikuar të njëjtat tarifa dhe të njëjtën cilësi si ato të përdorura për shërbimet e tyre (neni 42). Një kopje e marrëveshjes së interkoneksionit, e cila përcaktonte kushtet teknike dhe financiare të interkoneksionit, duhej t'i dorëzohej ERT-së (neni 43). Neni 43 gjithashtu lexon si më poshtë:

“Me marrjen e kërkesës, çdo organizëm me fuqi të ndjeshme në treg duhet t'i japë kërkesit një ofertë interkoneksioni.

Kur operatorët publikë të telekomunikacionit nuk arrijnë të lidhin marrëveshje interkoneksioni, brenda 2 muajve nga data e fillimit të bisedimeve, ERT-ja, pasi shqyrton pretendimet e tyre, nxjerr urdhër me shkrim për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.”.

21. Moszbatimi i urdhrit të ERT-së për të lidhur një marrëveshje interkoneksioni mund të çonte në gjobë (neni 96).

2. *Kodi i Procedurave Administrative, ligji nr. 8485, datë 12 maj 1999, siç ishte në fuqi në kohën në fjalë*

22. Neni 130 parashikonte që ekzekutimi i detyrimeve bazuar në një akt administrativ mund të zbatohet nga administrata pa shkuar në një gjykatë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Legjitimimi dhe statusi i viktimës, “TIBO Communications” sh.p.k.

23. Pas shkëmbimit të parashtrimeve ndërmjet palëve, anëtarët e shoqërisë kërkuese ndryshuan dhe emri i shoqërisë kërkuese ndryshoi disa herë. Shoqëria tani quhet “TIBO Communications” sh.p.k. Sipas regjistrit shtetëror të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, “TIBO Communications” sh.p.k. është e regjistruar me të njëjtin numër identifikimi fiskal si “Ofrues Shqiptar i Shërbimit Online” sh.p.k. Prandaj, ndryshimi i emrit të shoqërisë kërkuese nuk ndikoi në legjitimimin e saj në procesin gjyqësor para gjykatës.

24. Për më tepër, në mungesë të njohjes nga ana e autoriteteve të brendshme të shkëlqes së pretenduar të të drejtave të shoqërisë kërkuese dhe dëshmipërblimit, nuk mund të thuhet se shoqëria kërkuese e ka humbur statusin e viktimës.

25. Nisur nga sa më sipër, Gjykata hedh poshtë kundërshtimet e qeverisë, në lidhje me legjitimimin e “TIBO Communications” sh.p.k. dhe statusin e saj të viktimës.

B. Shkelja e pretenduar e paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës

26. Shoqëria kërkuese u ankua se e drejta e saj për akses në gjykatë ishte shkelur sepse gjykatat kishin refuzuar të shqyrtonin në themel pretendimet e saj kundër ofruesit me fuqi të ndjeshme.

27. Gjykata nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë kundërshtimin e qeverisë, në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 6, sepse ankimi sidoqoftë do të shpallet i papranueshëm për arsyet e përcaktuara më poshtë. Gjykata do të vazhdojë me supozimin se neni 6 është i zbatueshëm për faktet e çështjes.

28. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë janë përmbledhur së fundmi në çështjen *Grzęda kundër Polonisë* [DHM], nr. 43572/18, §§ 342-43, 15 mars 2022.

29. Në këtë çështje, kufizimi i së drejtës së aksesit në gjykatë të shoqërisë kërkuese rrjedh nga kërkesa ligjore për të përdorur mjet juridik administrativ në rast të moslidhjes së marrëveshjes së interkoneksionit me një ofrues me fuqi të ndjeshme. Shoqëria kërkuese nuk pretendoi – dhe Gjykata nuk ka arsye të vlerësojë – se kjo kërkesë nuk ndiqte një qëllim legjitim.

30. Shoqëria kërkuese u ankua për mënyrën se si funksiononte kërkesa në rastin e saj. Ajo argumentoi se kishte përdorur mjet juridik administrativ duke aplikuar në ERT, dhe se më 2 dhjetor 2003, ERT-ja kishte urdhëruar ofruesin me fuqi të ndjeshme që të lidhte një marrëveshje interkoneksioni. Qeveria pretendoi se ERT-ja nuk kishte lëshuar kurrë një urdhër individual për lidhjen e një marrëveshjeje interkoneksioni ndërmjet Albtelecom-it dhe shoqërisë kërkuese dhe se, sidoqoftë, shoqëria kërkuese nuk ishte ankuar në ERT për moszbatimin e këtij urdhri nga ofruesi me fuqi të ndjeshme.

31. Gjykata nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë nëse shkresa e datës 2 dhjetor 2003 mund të konsiderohet si “një urdhër”, sipas kuptimit të nenit 43, të ligjit për telekomunikacionin (shihni paragrafin 7 më lart) pasi, gjithsesi, shoqëria kërkuese nuk kishte depozituar ndonjë ankim në ERT, në lidhje me moszbatimin e një urdhri të tillë, mundësi kjo që ishte e hapur sipas nenit 130 të Kodit të Procedurës Administrative, siç ishte në fuqi në kohën në fjalë (shihni paragrafin 22 më lart). Prandaj, gjetjet e gjykatave vendase, në lidhje me mosshkrimin nga shoqëria kërkuese të mjeteve juridike administrative nuk duken arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Prandaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e brendshme nuk e kufizuan në mënyrë disproporcionale të drejtën e shoqërisë kërkuese që një gjykatë të vendosë mbi pretendimet e saj.

32. Nga kjo rrjedh se ankimi për mungesën e aksesit në gjykatë është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet, në përputhje me paragrafin 3 (a) dhe 4, të nenit 35 të Konventës.

C. Shkelja e pretenduar e nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës dhe nenit 13 të Konventës

33. Shoqëria kërkuese u ankua se kishte pasur një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe nuk kishte asnjë mjet efektiv për të mbrojtur të drejtën e saj për të ushtruar aktivitetin e saj.

34. Gjykata vëren se ankimi sipas nenit 13 është në thelb i njëjtë me atë sipas paragrafit 1, të nenit 6, dhe, për aq sa nuk është inkorporuar nga ky i fundit (shihni *Kudla kundër Polonisë* [DHM], nr. 30210/96, § 146, GJEDNJ 2000-XI), është po aq i papranueshëm.

35. Kur një kërkues nuk arrin të përmbushë kërkesat e brendshme të pranueshmërisë, kërkesa e tij ose e saj para Gjykatës, në parim, duhet të shpallet e papranueshme për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme (shihni *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* (kundërshtim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, § 72, 25 mars 2014).

36. Në këtë çështje, ankimi i shoqërisë kërkuese për aksesin në gjykatë u shpall i papranueshëm me arsyetimin se nuk ishin shteruar mjetet juridike administrative dhe se rezultati nuk ishte në mospërputhje me të drejtën e shoqërisë kërkuese për akses në gjykatë (shihni paragrafin 32 më lart).

37. Prandaj, Gjykata pranon kundërshtimin e qeverisë, në lidhje me mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme dhe vlerëson se ankimi, sipas nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës, është i papranueshëm për mosshkrim të mjeteve juridike të brendshme sipas paragrafëve 1 dhe 4, të nenit 35 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,
Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 16 maj 2024.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Georgios A. Serghides
PRESIDENT